



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET

EEAABAC

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

**LICENSIMI DHE SHPËRNDARJA E VEPRAVE MULTIMEDIALE ONLINE.
E DREJTA EUROPIANE DHE SFIDAT NË TË ARDHMEN.**

Dr. Blendi Himçi

Departamenti i së Drejtës – UNIEL

DEBATI TEORIK

- *Licensimi dhe shpërndarja e veprës lidhen ngushtësisht me **konceptin e pronësisë**. Mbi të drejtat që mund të lindin nga PI, **jusnatyralistët dhe utilitaristët përballen me kundërshtarët e PI.***
- *Sipas **jusnatyralistëve (Schulman, Rand)**, krijimet e mendjes **duhet të mbrohen në të njëjtën mënyrë si sendet e prekshme, sepse njeriu posedon trupin dhe punën e tij.***
- *Sipas **utilitaristëve (Poster, Friedman)**, krijimet e mendjes duhet të mbrohen mbi bazë ligjore dhe ekonomike: **duhet të zgjedhim ligjet dhe politikat që maksimizojnë pasurinë.***

DEBATI TEORIK

- *Sipas kundërshtarëve të PI (Galambos, Palmer, Tucker),*

a) kundërshtimi ndaj jusnatyralistëve:

nuk mund të posedohen objekte ideale, por vetëm resurset e shterueshme;

b) kundërshtimi ndaj utilitaristëve:

qëllimi i ligjit nuk është maksimizimi i pasurisë, por vendosja e drejtësisë.

DEBATI TEORIK

- *Cfarë problemesh mund të lindin nga njohja e të drejtave të pronësisë mbi idetë?*
- *Sipas autorit Kinsella, nëse njihen të drejta të pronësisë mbi rezurse të pashterueshme, atëherë do të pakësohen ndjeshëm të drejtat mbi ato të shterueshme*.*
- *Lockes mbështet teorinë e fitimit të pronësisë me titull origjinal (parimi i «homestanding»): kush që gjen i pari një mjet të shterueshëm që nuk posedohet nga të tjerë , bëhet pronari i saj.*

*Kinsella N.S. *Against intellectual property*, Ludvig von Mises Institute, Alabama, USA, 2008, në <http://mises.org/books/against.pdf>, parë në dt. 04.11.2012, fq. 41-43.

DEBATI TEORIK

Ky parim zëvendësohet nga mbështetësit e PI nga një tjetër rregull fitimi pronësie:

- ai i njohjes së të të drejtave në favor të atij që ka ide të reja mbi pronën e prekshme që posedohet nga të tjerë.

-Psh. nëse shpik një mënyrë të re të hapjes së një pusi, mund të ndalojë të gjithë të tjerët të hapin puset «edhe» në pronat e tyre.

DEBATI TEORIK

- Meqë **kundërshtarët e PI** argumentojnë se mund të njihen të drejta pronësie vetëm mbi resurset e shterueshme, shumë prej tyre **janë pro përdorimit të kontratave si mjet i përshtatshëm për mbrojtjen e ideve.**

-**A mund të zëvendësohet njohja e të drejtave të pronësisë mbi PI nga autonomia kontraktore?**

- **Limitet e kontratave: vlejnë vetëm mes palëve dhe jo për të tretët.**

DEBATI TEORIK

- *Për të shmangur këtë kufizim, Rothbard propozon rezervimin e të drejtave.*
- *Psh. nëse e drejta e pronësisë konsiderohet si një e drejtë që mund të ndahet , atëherë X, pronar i një trualli mund t'i shesë një shoqërie petrolifere pasuritë minerale, duke rezervuar të gjitha të drejtat e tjera mbi pronën, me përjashtim të një servituti kalimi në favor të fqinjit të tij.*
- *Pra, sipas teorisë së rezervimit të të drejtave, mund të krijohen privatisht të drejta mbi PI, duke rezervuar psh. të drejtën për të riprodhuar veprën.*

DEBATI TEORIK

- *Por a mund të posedohen idetë? A mund të rezervohet psh. e drejta për të mbajtur mend dicka? Edhe nëse kjo do të ishte e mundur si do të rregulloheshin marrëdhëniet me të tretët?*
- *Sipas parimit se askush nuk mund t'i kalojë dikujt më shumë të drejta sec ka ai vetë, Rothbard argumenton:*
- *nëse A krijon dhe shet një send që përbën shpikje (psh. thjesht duke e parë nga B që e ka blerë nga C me rezervën e riprodhimit), ai do të shkelte të drejtat e pronësisë (edhe në mungesë të kontratës mes A dhe C).*
- *Ju duket i arsyeshëm ky argumentim? A është e nevojshme të parashikohet mbi sendin X (pronë e A/së) e drejta për ta përdorur sendin në një mënyrë të caktuar?*

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

- *Liria e shprehjes, në kuptimin jo vetëm të komunikimit, por në kuptimin më të gjerë të realizimit të individit shfaqet edhe (madje sidomos) nëpërmjet rrjeteve informatike online.*

- *Ndalimi i komunikimit në rrjet mund të sjellë pasoja me karakter ekonomik (psh. kryerja e një shërbimi online), ose social (social web), si psh. administrimi i një blogu apo korrrespondenca e-mail.*

MANTELERO A., *Diritto d'accesso alle reti informatiche e tutela del diritto d'autore in Europa dopo la pronuncia del Constitutionnel sulla legge Hadopi*, në http://staff.polito.it/alessandro.mantelero/Mantelero_Diritto%20di%20accesso.pdf, parë në dt. 04.11.2012, fq. 8.

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

- Kalimi nga sistemi analog në atë dixhital ndikon në rregullimin ligjor të kontratave mbi të drejtën e autorit në dy drejtime.

- 1. kush mund publikojë përsëri përmbajtjen e veprave që i përkasin të shkuarës nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne?***
- 2. rregullimi ligjor i kontratave mbi të drejtën e autorit që i referohet sistemit analogjik është ende i përshtatshëm në sistemin dixhital? Pra, duhen interpretuar dispozitat e vjetra ligjore sipas një fryme evoluese, apo duhen menduar ndërhyrje ligjore riformuese?**

***Kjo pyetje shtron debatin mbi efikasitetin e marrëveshjeve të arritura përpara krijimit të këtyre teknologjive, por që i referohen çdo lloj mënyre të shfrytëzimit të veprave apo performancave artistike mbi të cilat është arritur marrëveshja.**

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

- **Shfrytëzimi i prekshëm** i veprës mund të arrihet nëpërmjet të drejtës së riprodhimit të veprës, të përpunimit dhe shpërndarjes.

- **Shfrytëzimi i paprekshëm** i saj, mund të realizohet nëpërmjet të drejtës së komunikimit në publik.

-

Kuptimi tradicional i shfrytëzimit të vepës nënkuptonte shfrytëzimin e saj nga një nr. i pakufizuar të mbledhur në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë.

- **Sot komunikimi** nënkupton edhe rastet e shfrytëzimit të veprës nga persona që ndodhennë vende të ndryshme dhe në kohë të ndryshme.

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

-Në lidhje me licensimin dhe shpërndarjen e veprave multimediale on-line, doktrina përdor termin «nyje» (dhe jo «konflikt» apo «raport») për të shprehur më mirë marrëdhënien mes elementëve objekt analize*.

- Këta elementë nuk mund të analizohen në mënyrë të pavarur sepse janë të ndërthurur ngushtë me njëri-tjetrin.

-Qëllimi i analizës nuk është të zgjidhet «nyja» apo «konflikti» por të gjendet nyja më e përshtatshme për të arritur një qëllim të caktuar.

****Montagnini M. L., Il diritto d'autore nell'era digitale. La distribuzione on line delle opere dell'ingegno, Giuffrè, Milano, 2012, fq. 157.***

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

- Elementët e nyjes së parë

Mbrojtja e të drejtave të autorit & qarkullimi dhe aksesit në informacion. Ndërthurja e tyre lidhet me rregullimin ligjor të përjashtimeve dhe kufizimet e të drejtës së autorit në mënyrë të tillë që të mos preken interesat e palëve të treta.

- Elementët e nyjes së dytë

Hard law & soft law në të drejtën komunitare. E para me tendencë për të mbrojtur të drejtën e autorit ndërsa e dyta shpërndarjen e informacionit.

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

- Elementët e nyjes së tretë

Krijimi dhe shpërandrje tregtare & krijimi dhe shpërandrje amatoriale. Zgjidhjet e reja të ofruara nga rrjeti internet i japin mundësi shfrytëzuesve të veprave në rrjet të marrin një rol aktiv (krijohen vepra dixhitale nga vetë përdoruesit).

- Dallohet: *shpërndarje e hapur dhe e mbyllur;*

shpërndarje interaktive dhe jo interaktive.

Këta elementë mund të ndërthuren me njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme: shpërndarja e hapur nuk nënkupton domosdoshmërisht atë interaktive.

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

Aspekte të tjera kritike, përvec nyjeve, janë:

1. *Marrëdhënia teknologji & normativizmi ligjor.*

Debati mbi dinamizmin e informacionit si kapital jo material dhe “ngurtësimin” e tij nga normativizmi ligjor.

2. *Globalizimi i rrjetit & territorialiteti i të drejtës së autorit.*

Debati mbi lehtësimin i qarkullimit të informacionit përtej kufijve gjeografikë.

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

- *Psh. kontratat që lidhen për shpërndarjen tregtare të informacionit dixhital lidhen offline.*
- *Nga ana tjetër, në shpërndarjen amatoriale (jo tregtare), përmbajtjet e realizuara nga vetë përdoruesit qarkullojnë dhe shfrytëzohen tërësisht në rrjet.*
- *Kjo do të thotë se nuk mund të zbatohen kriteret e përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare private (vendi ku ndodhen palët dhe vendi ku realizohet publikimi).*

MBROJTJA E TË DREJTAVE MBI VEPRAT MULTIMEDIALE ONLINE

3. Ekonomia tregtare dhe ekonomia e ndarjes së informacionit.

Kjo e fundit nuk shkel domosdoshmërisht të drejtat e autorit, psh. projektet open source si GNU/LINUX, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e software dhe zhvillimin e tyre duke evituar fenomenin «free riding».*

*- Ky model i prodhimit ekonomik në të cilin aktiviteti i një grupi personash koordinohet në projekte të rëndësishme **nuk ka një organizim hierarkik.** Nga kombinimi i dy formave të sipërpërmendura të ekonomisë ka lindur ajo që njihet si «**ekonomia hibride**».*

**Me termin “free riding” kuptohet procesi i financimit në të mirat publike: nëse kontributi do të ishte vullnetar secili do kërkonte që të paguanin të tjerët ndërsa ai vetë të përfitonte falas nga këto të mira.*

MËNYRA E SHPËRNDARJES SË PËMBAJTJEVE DHE SHËRBIMEVE

AUDIOVIZIVE

- Aktualisht shpërndarja e përmbajtjeve dhe shërbimeve audiovizive mund të kryhet nëpërmjet 5 platformave teknologjike:

- 1. analogjike dhe dixhitale tokësore;*
- 2. satelitare;*
- 3. bandë e gjerë*
- 4. teknologji DSL ose fibër optike*
- 5. « mobile ».*

MËNYRA E SHPËRNDARJESSË PËMBAJTJEVE DHE SHËRBIMEVE

AUDIOVIZIVE

Tregu i shpërndarjes dixhitale mund të paraqitet në disa forma:

- a) shpërndarje tregtare/amatoriale;*
- b) shpërndarje e hapur/e mbyllur;*
- c) shpërndarje interaktive dhe jo interaktive.*

*Me qëllim që të gjendet një ekuilibër, theksohet **domosdoshmëria për të njohur regjimin e përjashtimeve nga e drejta e autorit si rregull dhe jo më si anomali e sistemit***.*

**Shih iniciativën *A Single Market for Intellectual Property Rights* e cila ka për qëllim të analizojë mundësinë e krijimit të një Kodi European mbi të drejtën e autorit. Ai kodifikon direktivat si dhe mundësinë e krijit të një *copyright* të vetëm duke u bazuar në nenin 118 të TFBE; shih shpërbilimin i titullarëve të të drejtave të autorit nëpërmjet metodës *share-revenue: rasti YouTube*.*

MËNYRA E SHPËRNDARJES SË PËMBAJTJEVE DHE SHËRBIMEVE AUDIOVIZIVE

- Dallohen **4 modele të ndryshme shpërndarjeje***:
- 1. pronësor jo ndërveprues (librat dixhital) – i ngjashëm me atë të mediashop në veprat letrare, në të cilën përfitimi ekonomik rrjedh nga cdo transaksion i vecantë me përdoruesin; niveli i ndërveprueshmërisë (karakteristikë e web 2.0) është pothuajse zero sepse si rregull fluksi i informacioni është me një drejtim, nga website drejt përdoruesit.**

*Montagnini M. L., *Il diritto d'autore nell'era digitale. La distribuzione on line delle opere dell'ingeno*, Giuffrè, Milano, 2012, fq. 148-152. **Web 2.0.** në dallim nga versioni i mëparshëm ofron **jo vetëm akses në informacion por dhe ndërveprueshmëri me përdoruesit**, të cilët marrin një rol aktiv duk u kthyer sipas rastit në autorë të veprave që konsultojnë online.

MËNYRA E SHPËRNDARJES SË PËMBAJTJEVE DHE SHËRBIMEVE **AUDIOVIZIVE**

***2. pronësor ndërveprues (muzika, videot dhe më pak videogames);
klasifikimi si pronësor lidhet me faktin se e drejta e autorit fitohet
në mënyrë ekskluzive dhe të përhershme nga website në momentin
kur përdoruesi/autor hedh materialin online dhe shpërblehet për
të.***

***- Pas kësaj, përdoruesi/ autor humbet mundësinë për të vendosur
kushtet e shfrytëzimit të materialit të hedhur on line nga të tjetrët.***

***Pra, qëndrueshmëria ekonomike e sitit varet nga
ndërveprueshmëria mes website dhe përdoruesit.***

MËNYRA E SHPËRNDARJESSË PËMBAJTJEVE DHE SHËRBIMEVE **AUDIOVIZIVE**

3. i hapur ndërveprues (përmbajtjet audiovizive);

klasifikimi si i hapur varet nga përmbajtja e informacionit (dhe jo vetëm nga regjimi i të drejtës së autorit), i cili shpërndahet falas dhe fitimet rrjedhin nga sistemi i publicitetit; ka ndërveprim mes përdoruesve/autorë dhe website.

4. i hapur jo ndërveprues (radio dhe televizioni web);

klasifikimi rrjedh nga sistemi i hapur i të drejtës së autorit pasi materialet ofrohen falas; por fluksi informacionit shpërndahet vetëm në një drejtim, nga website drejt përdoruesit; përdoret publiciteti dhe ka pak kufizime teknologjike.

**ZGJERIMI I TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT EKONOMIK NGA
MBJENTI ANALOG NË ATË DIXHITAL**

-Marrëveshja OBPI tregon për shtrirjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të edhe në ambjentin dixhital.

-Vendosja e të dhënave online nga autori i tyre përbën padiskutim një të drejtë të autorit.

-Pyetja që shtrohet është nëse ky veprim përbën një specifikim të së drejtës së autorit apo një të drejtë më vete?

ZGJERIMI I TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT EKONOMIK NGA MBJENTI ANALOG NË ATË DIXHITAL

- *Për të realizuar përhapjen e veprës në publik është e domosdoshme të bëhet një kopje e saj, ndërkohë që vendosja e veprës online mund të konsiderohet si shpërndarje e veprës (autori i veprës duhet të japë pëlqimin për përhapjen apo shpërndarjen e saj).*
- *Nëse ngarkimi (vendosja online) e materialit të mbrojtur nga e drejta e autorit kryhet nga një subjekt tjetër, shtrohet pyetja: si do të rregullohen nga pikëpamja ligjore këto veprime?*
- *Zgjidhja e ofruar nga WCT i lë hapësirë vendeve anëtare t'i kategorizojnë lirisht këto veprime («umbrella solution»).*

**ZGJERIMI I TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT EKONOMIK NGA
MBJENTI ANALOG NË ATË DIXHITAL**

Një zgjidhje e mundshme mund të ishte ajo që konsideron vendosjen e materialit të mbrojtur nga e drejta e autorit on line si përmbledhje e tre veprimeve të vecanta:

- a) riprodhim i veprës, në momentin e dixhitalizimit të veprës;*
- b) përhapje e veprës në publik, në momentin që vepra bëhet disponibël për publikun duke u ngarkuar on line;*
- c) shpërndarje e veprës në publik në momentin që materiali shfrytëzohet nga publiku.*

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- *Nevoja për balancimin e interesave në të drejtë komunitare.*

Procedimi në dy binarë paralelë, të cilët shfaqen të shfazuar me njëri-tjetrin: hard law dhe soft law.

-*Rregullimi ligjor (hard law) komunitare nuk pasqyron frymën e soft law, sipas të cilit theksi vihet te e drejta e autorit si mjet dhe jo qëllim për rritjen ekonomike, sociale dhe kulturore të shoqërisë.*

- *Zhvillimi i një tregu të përbashkët komunitar nuk mund të mos marrë parasysh interesat e konsumatorëve në rolin e tyre të ri (jo vetëm përdorues por edhe krijues).*

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- Në kuadrin e *inciativës së Komisionit EU, Audiovisual and media policy*, me temë «**Content online**», konsultimet publike lidhur me ofertën e përmbajtjeve dhe shërbimeve që përmbushin nevojat e konsumatorëve, përfunduan në **European Charter for the Development and the Take-up of Film online**.

- *Kjo politikë nuk gjen mbështetje nga rregullimi ligjor komunitar i cili ka zgjeruar spektrin mbrojtës të të drejtës së autorit si për sa i përket objektit, kohëzgjatjes dhe mjeteve mbrojtëse.*

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- Në lidhje me të drejtën e autorit, **shfrytëzimi i veprave** rregullohet nga **neni 5 KB**, i cili vendos **kriterin e territorialitetit** (ashtu si dhe te KR*, ndërkohë që TRIPs i referohet KB):
të drejtat mbi të mirat jo materiale rregullohen nga ligji i shtetit në të cilat ato përdoren.
- **Si përcaktohet gjeografikisht shfrytëzimi i veprës?**

**Konventa ndërkombëtare e Romës e vitit 1961 "Për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese".*

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

-Dir. 93/83 mbi radiodifuzionin satelitar dhe ritransmetimin kablor, zgjidh problemin e ligjit të zbatueshëm në transemtimet jashtë kufijve.

- Alternativat në momentin e hartimit të direktivës ishin dy:

a) vendi i origjinës (i pranuar nga Dir.);

b) vendi i marrjes.

- Përzgjedhja e vendit të orriginës u argumentua me faktin se në transmetimin me satelit do të ishte i mjaftueshëm refuzimi i licencimit të njërit prej titullarëve të një shteti anëtar që vepra të mos shpërndahej në vendet e tjera.

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- *Mundësia e shtrijes së kriterit të vendit të originës edhe përtej shpërndarjes me satelit është sot objekt diskutimesh.*
- *Dir. 2007 “TV pa kufij” përcakton ligjin e zbatueshëm duke u bazuar në kriterin e shfrytëzimit të veprës. Ky kriter zgjidh problemin e përcaktimit të ngarkimit të materialit që transmetohet online.*
- *Vendi ku ndodh komunikimi ka rëndësi dytësore. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që kur një sistem efikas DMR (Digital Media Rights) mundet të përcaktojë juridikisht momentin e aksesit të veprës, të përcaktojë shpërblim më vete për çdo shfrytëzim individual të saj.*

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

Rregullorja nr. 864 e vitit 2007 "Mbi ligjin e zbatueshëm në detyrimet jashtëkontraktore (Roma II)", përcakton se:

ligji i zbatueshëm i detyrimeve jashtë kontraktore që rrjedh nga shkelja e një të drejte të pronësisë intelektuale është ai i vendit në të cilin kërkohet mbrojtje.

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- Në lidhje me shpërndarjen e bazës së të dhënave (si një kategori e mbrojtur nga e drejta e autorit) gjen zbatim parimi i ezaurimit të së drejtës (ose doktrina e shitjes së parë):

pasi vepra është hedhur në treg në territorin e BE-së, nga titullari i së drejtës ose me konsesusin e tij, e drejta ezaurohet, pra të tjerët janë të lirë ta shfrytëzojnë veprën sipas dëshirës.

- Përrjashtim bën shpërndarja e kampionarëve me qëllim publiciteti ose shpërndarja për kërkim shkencor: në këto raste e drejta nuk ezaurohet.

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

Rezoluta mbi industrinë kulturore në Europë e Parlamentit europian (10 prill 2008) :

- ***(...)interneti përbën një hapësirë të gjerë për shprehjen e kulturës, aksesin në njohuri, pjesëmarrjen demokratike në krijimtarinë europiane, kohezionin mes gjeneratave në sajë të shoqërisë së informacionit;***
- ***shtetet anëtare duhet të: shmangin marrjen e masave që janë në kundërshtim me liritë civile, të drejtat e njeriut dhe parimet e proporcionalitetit, efikasitetit dhe të parandalimit, sic janë ndërprerja e aksesit në internet.***
- ***ndërprerja e lidhjes në internet mund të kryhet vetëm mbi bazën e një vendimi gjyqësor.***

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

Shkeljet e të drejtës së autorit në internet rregullohen:

***- në Europë nga EUCD - European Union Copyright Directive (2012)
dhe ECD - Electronic Commerce Directive (2000).***

- në SHBA nga DMCA - Digital Millennium Copyright Act (1998).

***Të dyja parashikojnë mungesën e përgjegjësisë direkte apo indirekte të
OSP (Online Service Provider) dhe të ndërmjetësve të tjerë të
mundshëm,***

***me kusht që ata të ndërmarrin masa të bllokimit apo heqjes së
informacionit që konsiderohen si shkelje e të drjtës së autorit, nga
momenti që ata marrin njoftim nga titullari i së drejtës së autorit apo
nga një përfaqësues i tij.***

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

Rregullorja (CE) n. 1/2003:

- ***autorizon autoritetet kompetente të vendeve anëtare të BE/së që në marrëveshjet e transferimit të teknologjisë, të revokojnë përjashtimet nga e drejta e autorit kur ato sjellin pasoja që bien në kundërshtim me nenin 101, par. 3, i TFBE.***
- ***vendet anëtare të BE/së duhet të garantojnë që ky revokim nuk do t'i sjellë dëme zbatimit uniform të normave komunitare në lidhje me konkurrencën në tregun e brendshëm.***

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- **Dir. 2000/31/CE (mbi tregtinë elektronike), rregullon përgjegjësinë e ofruesve të shërbimeve:**

- a) gjatë transferimit të të dhënave (mere conduit);**
- b) gjatë memorizimit të përkohshëm të tyre (caching) ;**
- c) nga memorizimi i infomacionit që mund të kryhet nga përfituesi i shërbimit (hosting).**

- **Dir. 2009/140/CE (mbi komunikimin elektronik), lejon kufizimin e përdorimit të internetit kur është i përshtatshëm, i proporcionuar dhe i domosdoshëm në një shoqëri demokratike.**

- **Direktiva ka eliminuar gjithashtu domosdoshmërinë e një ndërhyrje ekskluzive të autoriteteve gjyqësore.**

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- Në 2009 Komisioni europian nëpërmjet komunikimit mbi “të drejtën e autorit në ekonominë e njohjes” (COM (2009) 532), ka vënë theksin në gjetjen e një dialogu mes tre kategorive mbartëse të interesave të ndryshme:

- a) *titullarët e të drejtës së autorit;*
- b) *konsumatorët;*
- c) *përdoruesit tregtarë.*

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- **Dir. 2001/29** ka patur për **qëllim** gjetjen e një **emëruesi të përbashkët** mes **përrjashtimeve dhe kufizimeve** nga e drejta e autorit **dhe mjeteve të reja teknologjike** që shërbejnë për mbrojtjen e kesaj të drejte.
- **Neni 5 Dir. 2001/29** parashikon **përrjashtimet dhe kufizimet që vendet anëtare mund të njohin pas hyrjes në fuqi të Dir.**
- **Par. 2, gërma b) Dir. :** shtetet anëtare mund të parashikojnë **përrjashtime nga e drejta e riprodhimit në lidhje me riprodhimin e kryer nga një person fizik për përdorim privat mbi cdo suport dhe për qëllim që nuk mund të jetë as direkt as indirekt tregtar.**

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

-Kjo me kusht që titullarët e të drejtave të kompensohen nëpërmjet një shpërblimi të drejtë, përcaktimi i të cilit duhet të marrë në konsideratë edhe përdorimin ose jo të mjeteve teknologjike.

- Nga ana tjetër, neni 6 par. 4 Dir. lejon titullarët e të drejtave “të marrin masat e duhura në lidhje me numrin e kopjeve që mund të riprodhohen ”

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

- ***Neni 5 i Dir 2001/29 mbi shoqërinë e informacionit përmban një listë të mbyllur të përjashtimeve dhe një kaluzolë gjysëm të hapur në par.5, që është testi me tre gradë (3ST). Kombinimi i tyre ofron siguri juridike dhe fleksibilitet.***
- ***Shtrohet pyetja: a duhet të bëhen të detyrueshëm par. 2 dhe 3 të nenit 5 Dir. mbi përdorimet e lira? Cfarë pasojash do të rridhnin prej saj?****

****Montagnani M. L., Il diritto d'autore nell'era digitale, La distribuzione on line delle opere dell'ingegno, Giuffrè, Milano, 2012, fq. 185.***

KUADRI NORMATIV KOMUNITAR

-Sipas të drejtës komunitare, e drejta për ta ofruar veprën dixhitale në publik («making available») nuk ezaurohet me hedhjen për herë të parë të produktit në treg por shtrihet edhe në shpërndarjen e kopjeve të tjera në treg.

-Në këtë mënyrë evitohet që një kopje e veprës të shpërndahet nga persona të ndryshëm nga autori i saj (pa pëlqimin e tij).

-Kjo do të thotë se parimi i ezaurimit të së drejtës së autorit nuk vlen për veprat dixhitale. Pra, përdoren dy regjime të ndryshme mbrojtjeje: nëse vepra është materializuar (fiksuar në suport fizik) ose jo (mund të shfrytëzohet on line).

Shih vendimin gjyqësor në slide nr. 47.

SHPËRBLIMI /KOMPENSIMI I DREJTË

- Teoria e pëfitimit indirekt, e ideuar nga ekonomistit kanadez Stan Liebowitz në vitet '80:

-fitimet e humbura nga titullarët dhe licensuesit e të drejtave nga mungesa e shitjes së kopjeve të një vepre për shkak të kopjes private, mund të recuperohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme, sic është psh. detyrimi për të paguar një cmim më të lartë nga blerësi i kopjes së parë.

-Ky është rasti i revistave shkencore të cilat blihen nga bibliotekat e universiteteve me cmime më të larta në krahasim me kuotat e abonimit që vendosen për kategoritë e tjera të përdoruesve.

SFIDA NË EUROPE

Libri i Gjellbër

mbi shpërndarjen online të vepave audiovizive në BE (2011)

Komisioni europian ka permbledhur problemet e shperndarjes se veprave audiovizive on line ne Librin e Gjellbër mbi shpërndarjen online të vepave audiovizive në BE 20

Shih versionin anglisht në

http://ec.europa.eu/internal_market/consultations/docs/2011/audiovisual/green_paper_COM2011_427_en.pdf

SFIDA NË EUROPË

- *Në raportin e fundit të Observatorit me titull: **Must-carry: Renaissance or Reformation?** vihet theksi në fragmentizimin e tregut audioviziv.*
- *Në Europë ligjvënësit po përpiqen t'i sigurojnë **vizibilitet përmbajtjeve me interes të përgjithshëm**, të propozuara kryesisht nga kanalet shpërndarëse publike.*
- *Detyrimi i shpërndarjes (**must-carry**) dhe i ofertës (**must-offer**) ka për qëllim të garantojë aksesin në disa rrjete transmetimi të kanaleve specifike.*

SFIDA NË EUROPE

- Në këtë mënyrë **garantohet shumllojshmëria e ofertës, dhe qëndrueshmëria ekonomike e disa rrjeteve shpërndarëse.**
- Rregullat “must carry” bazohen në **nenin 31 të Dir. mbi shërbimin universal: detyrimi i shpërndarjes “mund t’iu vendoset vetëm rrejteve që përbëjnë mjetin kryesor të marrjes së programeve radiofonike dhe televizive për një numër të konsiderueshëm përdoruesish final”.**
- Rregullat “must carry” janë **“teknologjiskisht neutrale”**: zbatohen **pa dallim si për linjën kabllore, atë satelitore, rrjetin tokësor apo atë IPTV. Ky rregullim i referohet vetëm “aftësisë së shpërndarjes dhe jo përmbajtjes së tyre”.**

PRAKTIKË GJYQËSORE

GJED, C-128/11, Usedsoft GmbH kundër Oracle *

vendimi dt. 3 korrik 2012.

Në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale në rrjetin internet GJED, duke u bazuar në parimin e ezaurimit të së drejtës, ka vendosur se shitja e software-ve të licensuara në internet është e mundur me kusht që shitësi që ka marrë licensën të disinstalojë ose të mos përdorë më programin e shitur.

*<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=124564&pageIndex=0&doclang=EN&mode=req&dir=&occ=first&part=1&cid=2580446>

PRAKTIKË GJYQËSORE

- Gjykata e ka mbëshetur **argumentimin** mbi bazën e një **paralelizmi mes shitjes/licencës offline** (tregtimi i software nëpërmjet suroteve informatike) **dhe asaj online** (nëpërmjet shkarkimit ose download-imit).

-Shitësi/licensuesi është shpërblyer në mënyrë të drejtë me shitjen/licensimin e parë të produktit, pra e drejta e tij ezaurohet në këtë fazë, nuk mund ta përdori sërish.

-Ai nuk mund të pretendojë të bllokojë qarkullimin e mëtejshëm të produktit, pasi në këtë mënyrë ai përfiton një shpërblim extra të paligjshëm.

PRAKTIKË GJYQËSORE

- *Vendimi ka rëndësi të vecantë nëse i referohemi muzikës apo produkteve video, sepse qarkulli i produkteve apo shërbimeve on line nuk mund të ndalohej nëse shitësi i parë ka marrë shpërbilimin e duhur .*
- *Problemet lindin në zbatimin praktik. Si do të verifikohet disinstalimi apo mospërdorimi ?*



Kontakt:

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Faleminderit për vëmendjen!

Pyetje?

Dr. Av. Blendi Himçi

Department of Law
Faculty of Economy
University of Elbasan

Blendi.himci@uniel.edu.al



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES